

MARRËVESHJE

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

MINISTRIT TË SHETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E RINISË

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i Republikës së Shqipërisë, në vijim të quajtura “Palët”;

Të angazhua që të vijojnë nismat e ndërmarra në përputhje me Deklaratën e Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritetit Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, nënshkruar në Prizren, më 14 janar 2014;

Të bindur se të rinjtë mund të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të frymës së mirëkuptimit, tolerancës, miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve;

Të nxitur nga një frymë e mirëbesimit dhe bashkëpunimit të të dy vendeve në kuadrin e nismave rajonale dhe evropiane;

Me qëllim konkretizimin e bashkëpunimit për zbatimin e një programi gjithëpërfshirës në fushën e rinisë;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Palët synojnë bashkëpunim institucional të të dy vendeve në fushën e rinisë në mbështetje të politikave dhe programeve të përbashkëta si dhe të nismave rajonale dhe evropiane.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët do të ndërmarrin politika dhe programe të përbashkëta në mbështetje të frymës së bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe miqësisë ndërmjet dy vendeve në fushën e rinisë përmes:

1. Fuqizimit të zërit rinor në vendimmarrjen në nivel qendror dhe vendor;
2. Promovimit të vlerave më të mira evropiane për bashkëjetesë, tolerancë dhe integrim;
3. Hartimit dhe zbatimit të aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta për nxitjen e shkëmbimeve të rinjve, mbështetjes së këshillimit të karrierës dhe, zhvillimit të aftësive profesionale të të rinjve dhe mbështetjen e çdo çështje tjetër me interes për të rinjtë;
4. Nxitjes së pjesëmarrjes në konferenca e seminare në të dy vendet, rajon e më gjerë si dhe në aktivitete të tjera rinore që organizohen nga vetë ata, me synim forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve.

Neni 3

Forma e Bashkëpunimit

Palët do të nxisin veprimtari të përbashkëta dhe do të inkurajojnë bashkëpunimin në fusha me interes për rininë të tilla si:

1. Organizimi i konferencave dhe aktiviteteve të përbashkëta me karakter rajonal dhe ndërkombëtar që trajtojnë çështjet e rinisë;
 - a) Zhvillimi i panairit të mekanizmave/organizatave rinore;
 - b) Organizimi i sesioneve informuese rreth mundësive pozitive për të rinjtë në Evropë dhe më gjerë;
 - c) Shkëmbimi i vizitave të grupeve rinore, artistëve të rinj, sportistëve të rinj dhe profesionistëve të rinj dhe nxitja e bashkëpunimit mes tyre;
 - d) Inkurajimi i sipërmarrjes së të rinjve në fushën e shkencave kompjuterike, teknologjisë së informacionit, inovacionit dhe ndërmarrjeve sociale;
 - e) Mbështetje në organizimin e kampeve të përbashkëta me qëllim shkëmbimin e eksperiencave rinore dhe mbështetjen e edukimit joformal të të rinjve.
 - f) Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të organizatave rinore, krijimit të grupeve të përbashkëta të punës, këshillave koordinues dhe formave të tjera të organizimit rinor përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme;
 - g) Angazhimi i të rinjve në aktivitete vullnetare në shërbim të të dy vendeve.
 - h) Shkëmbimi i zyrtarëve përkatës me qëllim hartimin dhe realizimin e programeve dhe projekteve në fushat me interes për rininë.
 - i) Realizimi i të paktën 1 (një) aktiviteti në të dy vendet në muajin gusht në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë.
 - j) Mundësimi i pjesëmarrjes së të rinjve të vendit tjetër në ngjarjet dhe festivalet e mëdha rinore, kulturore dhe sportive të vendit të tyre.
 - k) Mbështetja e shkëmbimeve dhe vizitave të grupeve rinore. Në programin vjetor të aktiviteteve, Palët do të parashikojnë pjesëmarrjen e të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) të rinjve dhe 2 (dy) kujdestarëve nga secili vend, për 5 (pesë) ditë, në aktivitetet e zhvilluara në vendin tjetër.
 - l) Shkëmbimi i informacionit në lidhje me politikat dhe programet rinore, shoqatat rinore, organizatat rinore, qendrat rinore, rrjetet rinore në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, në fuqi në të dy vendet.

Neni 4

Partneriteti i Organizatave Rinore

Palët nxisin partneritetin mes organizatave rinore në vendet përkatëse për të përmirësuar nivelin e aplikimeve në projekte dhe programe të Bashkimit Evropian, të Këshillit të Evropës, të Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe nismave të tjera rajonale dhe ndërkombëtare me interes për Palët.

Neni 5

Programi Vjetor i Aktiviteteve

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, Palët hartojnë një program të përbashkët vjetor të aktiviteteve.
2. Palët do të miratojnë programin e përbashkët vjetor të aktiviteteve, brenda 2 (dy) muajve nga data e përfundimit të programit të vitit pararendës.
3. Palët do të përfundojnë monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të programit të përbashkët vjetor të aktiviteteve, brenda 2 (dy) muajve nga data e përfundimit të programit të vitit pararendës.
4. Angazhimet që Palët marrin përsipër në programin e përbashkët vjetor të aktiviteteve do të realizohen në përputhje me legjislacionin e shteteve Palë.

Neni 6

Financimi

1. Shpenzimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje përcaktohen në përputhje me programin e aktiviteteve të miratuar nga Palët.
2. Palët bien dakord të mbulojnë proporcionalisht aktivitetet e parashikuara në programin e miratuar të aktiviteteve.
3. Shpenzimet që rrjedhin nga aktivitetet e shkëmbimit të zyrtarëve dhe të rinjve, të parashikuara në programin e miratuar të aktiviteteve, do të rregullohen në bazë të reciprocitetit, si vijon:
 - a) Për delegacionet shtetërore, pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit të zyrtarëve të saj gjatë qëndrimit në vendin tjetër;
 - b) Për delegacionet e të rinjve, pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe sigurimin e shëndetit të të rinjve gjatë qëndrimit në vendin tjetër dhe pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e akomodimit të tyre në vendin e saj.
4. Angazhimet që Palët marrin përsipër në programin e përbashkët të aktiviteteve do të realizohen në përputhje me legjislacionin e shteteve Palë.

Neni 7

Komunikimi, Konfidencialiteti dhe Vlerësimi

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të rregullt dhe të shkëmbejnë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshjeje;
2. Palët zotohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe dokumentacionit të shkëmbyer dhe mos ta ndajnë atë me të tretë pa miratimin me shkrim të Palës tjetër.

Gjithashtu, informacioni dhe dokumentacioni i shkëmbyer nuk mund të përdoret për qëllime të tjera veç atyre të specifikuara në këtë marrëveshje.

3. Palët do të zhvillojnë, të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj, takime të përbashkëta për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të marrëveshjes dhe programit vjetor të aktiviteteve, si dhe për planifikimin e programit të aktiviteteve për periudhën e ardhshme.

Neni 8

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga ose gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje të zgjidhet me anë të konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet Palëve.

Neni 9

Ndryshimi e Marrëveshjes

Marrëveshja mund të ndryshohet ose të plotësohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të palëve.

Neni 10

Hyrja në Fuqi, Kohëzgjatja dhe Përfundimi

1. Marrëveshja lidhet për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe do të zgjatet automatikisht për periudha pasuese të njëpasnjëshme 5 (pesë) vjeçare.
2. Secila palë mund të njoftojë palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e Marrëveshjes. Përfundimi do ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.
3. Nënshkruar në PRISHTINË, më 20.06.2020, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, të gjitha kopjet janë njëlloj të vlefshme.

PËR

MINISTRINË E KULTURËS, RINISË

DHE SPORTIT

TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR

MINISTRIN E SHTETIT PËR RININË DHE

FËMIJËT

TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SHTOJCA: Modeli i Programit Vjetor të Aktiviteteve Kosovë - Shqipëri

**PROGRAMI I AKTIVITETEVE TË BASHKËPUNIMIT
NË FUSHËN E RINISË**



**MIDIS
MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

DHE

**MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VITI _____

2. Hyrja

Hyrja shpjegon qëllimin e programit, ndërlidhjen e objektivave dhe aktiviteteve të tij me synimet dhe objektivat e miratuara nga secila Qeveri për fushën e rinisë. Gjithashtu kjo pjesë shpjegon procesin e konsultimit, kohështrirjen, metodologjinë dhe arsyetimin e përzgjedhjes së objektivave dhe aktiviteteve të programit në raport me ndikimin e pritshëm. Në fund kjo pjesë përshkruan institucionet shtetërore, organizatat dhe partnerët e jashtëm që parashikohet të angazhohen dhe kontribuojnë në zbatimin e këtij programi.

3. Objektivat dhe aktivitetet specifike

Kjo pjesë paraqet në formë të listuar dhe të shtjelluar secilin objektiv / fushë të bashkëpunimit, aktivitetet specifike të dakordësuara, periudhën dhe vendin ku do të zhvillohen, parashikimin e buxhetit të nevojshëm dhe burimet për mbulimet e shpenzimeve me fonde shtetërore apo donatorët/projekte të jashtme, institucionet shtetërore ose aktorët jo shtetërorë përgjegjës për realizimin e objektivit/aktivitetit specifik, rezultatet dhe produktet e pritshme dhe identifikimin e rreziqeve dhe sfidave të cilat priten të paraqiten gjatë zbatimit.

Tabela e programit të aktiviteteve të bashkëpunimit në fushën e rinisë

Objekt	Nr	Aktivitete	Periudha e zbatimit				Buxheti i kerkuar	Burimi i financimit	Vendi i zbatimit	Institucionet përgjegjëse	Vlerësimi i rreziqeve	Rezultatet /indikatorët kyç	Vlerësimi cilësisë së performancës '0' = e papranueshme; '1' = minimale; 'e' = kënaqshmëri; 'e mirë'; 'shkëlqyeshme'
			T 1	T 2	T 3	T 4							

4. Monitorimi dhe vlerësimi

Kjo pjesë paraqet mekanizmin që Palët do të përdorin për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të bërë në zbatimin e programit të aktiviteteve, duke përfshirë formën dhe afatet e raportimit nga institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave/aktiviteteve specifike, evidentimin e pengesave në zbatim, sfidave dhe rekomandimeve për adresim në programin e ardhshëm të aktiviteteve etj.

1. Korniza

Korniza shpjegon kontekstin e programit të aktiviteteve dhe nënvizon dakordësinë e ndërsjellët të palëve mbi parashikimet e dokumentit të programit të përbashkët të aktiviteteve dhe mbi angazhimin e tyre në zbatimin e tij.

Ky seksion përfshin të paktën këto deklarata

MEQENËSE Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i Republikës së Shqipërisë kanë dakordësuar “Marrëveshjen për Bashkëpunimin në Fushën e Rinisë”, të nënshkruar në _____, më _____.

Bazuar në Nenin 5 të Marrëveshjes, Palët hartojnë dhe miratojnë çdo vit programin e aktiviteteve në mbështetje dhe për zbatim të objektivave të Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e rinisë;

Palët zotohen të venë në dispozicion burimet e brendshme dhe të mobilizojnë mbështetjen e jashtme për menaxhimin dhe zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë program dhe realizimin e qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Fushën e Rinisë si dhe synimeve të politikave kombëtare në fushën e rinisë të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha angazhimet që Palët marrin përsipër në programin e përbashkët vjetor të aktiviteteve do të realizohen në përputhje me legjislacionin, rregullat, politikat dhe procedurat kombëtare të secilës palë.

Nënshkruar në PRISHTINË më 20.06.2022

PËR MINISTRINË E KULTURËS, RINISË

DHE SPORTIT

TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR MINISTRIN E SHTETIT PËR RININË DHE

FËMIJËT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

